

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj e Lumni Sallauka – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses R.J. nga Gjilani rr. “...” nr..., kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria për Arsim, të cilën me autorizim e përfaqëson B.D., për shkak të kompensimit të pagave jubilarë, regresit dhe pagave përcjelljese në pension, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.248/2013, të datës 28.09.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.09.2018, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditëses R.J. nga Gjilani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.248/2013, i datës 28.09.2015, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.248/2013, të datës 28.09.2015, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses R.J. nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria për Arsim në Gjilan të detyrohet t’i paguaj regresin shumë në vlerë prej 774.14 €, për përcjellje në pension, dy paga në vlerë prej 774.14 €, të gjitha këto në vlerë të tërësishme prej 1668.28 €, me kamatë ligjore prej 3.2 % ashtu sa e paguajnë bankat në Kosovë dhe atë brenda afatit prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën e R.J.t nga Gjilani dhe ta anuloj apo ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.248/2013, të datës 28.09.2015.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditëses është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja R.J. me datë 18.03.2013, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensimin e pagave pas pensionimit kundër të

paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses t’ia paguaj regresin në shumë prej 120 €, për shpërblim jubilar dy paga në shumë me vlerë prej 774.14 €, për përcjellje në pension dy paga në vlerë prej 774.14 €, të gjitha këto të tërësishme prej 1668.28 €, me kamatë ligjore prej 3.2 % ashtu sa paguajnë bankat në Kosovë dhe atë brenda afatit prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse, në seancë të shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.248/2013, të datës 28.09.2015, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata, ndër të tjera ka theksuar se paditësja kërkesëpadinë e saj e bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës e miratuar dhe e nënshkruar nga BSPK-ja, Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale dhe Oda Ekonomike e Kosovës, e cila kontratë ka filluar të zbatohet gjegjësisht ka hyr në fuqi nga Janari i vitit 2005. Gjykata e shkallës së parë më tutje shton se e njëjta kontratë nuk ka qenë në fuqi në kohën kur paditësja ka shkuar në pension në Mars të vitit 2013, sepse është zgjedhur sipas fuqisë së ligjit në Janar të Vitit 2008.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur së është vendosur në mënyrë të drejtë duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë pasi që nga shkresat e lëndës rezulton së nuk ka qenë rrethanë kontestuese fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura deri në arritjen e moshës së pensionit, përkatësisht deri me datën 02.03.2013. Kjo rrethanë është provuar edhe nga vendimi i të paditurës i datës 11.03.2013, për pensionimin e punëtores. Kontrata Kolektive ka filluar të zbatohet nga data 01.01.2005, me kohëzgjatje të zbatimit për tri vite përkatësisht deri me datën 31.12.2007, kur të njëjtës i ka skaduar afati i zbatimit përkatësisht i ka pushuar efekti juridik, ndërsa kontrata tjetër kolektive ka filluar të zbatohet nga data 01.01.2015, e deri me 31.12.2017. Edhe sipas dispozitës së nenit 90 paragrafi 4 i Ligjit të Punës, përcaktohet se *“Marrëveshja kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”*.

Me skadimin e afatit të Kontratës Kolektive e njëjta nuk mund të aplikohet për rastet tjera pas datës 01.01.2008, e në rastin konkret as për rastin e paditëses meqë padia është

paraqitur në gjykatë me datën 18.03.2013, ndërsa paditësja është pensionuar me datën 02.03.2013, pasi që ka pushuar së zbatuari Kontrata (e parë) e Përgjithshme Kolektive, përkatësisht jashtë kohës brenda të cilës Kontrata Kolektive ka qenë në fuqi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1, pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.4444/15, me datën 17.09.2018**

**Kryetari i Kolegjit - Gjyqtari,**  
**Valon Totaj**